



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1812/Prot.
12

Tiranë, më 13.01.2025

VENDIM

Nr. 2, Datë 13/01/2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË PUNËS PËR VITIN AKADEMIK 2023-
2024, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe të nenit 49, pika 1, germa “h” të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afati për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Udhëzuesit të AKFAL Nr. 75/3 Prot., datë 11.07.2023 “Për modelin e raportimit vjetor të IAL, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Sportit dhe Arsimit” të AKFAL, pranë MAS, si dhe të nenit 48, pika 1, germa “m”, me titull “Funksionet e Bordit të Administrimit të UART” dhe nenit 147, me titull “Raportimi” të Statutit të Universitetit të Arteve, Bordi i Administrimit, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin vjetor të punës për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe një kopje t’i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ

(Kryetar)

Prof. Besnik Bisha


(Anëtar)

Jeton SHEHU



(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI



(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

(Anëtar)

Vladimir LLAKAJ



(Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Nr. 1812/4 Prot.

Tiranë, më 06.01.2025

Lënda: Dërgohet për miratim raporti i analizës vjetore të punës

SENATIT AKADEMIK, UART
BORDIT TË ADMINISTRIMIT, UART



Të nderuar,

Rektorati i Universitetit të Arteve, dërgon për miratim në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit raportin e analizës vjetore të punës për vitin akademik 2023-2024, mbështetur në nenin 32 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Udhëzimin e MAS nr. 5, datë 19.2.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar, në Udhëzuesin e AKFAL "Për modelin e raportimit vjetor të IAL-ve, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit", në Statutin e UART, në pikën 6 të Urdhrit të Rektorit nr. 54, datë 11.11.2024 "Për zhvillimin e analizës vjetore të punës për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Arteve", si dhe në Urdhrin nr. 54/1, datë 20.12.2024 "Për marrjen e masave për zhvillimin e analizës vjetore të punës për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Arteve".

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORATI I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor

Prof. Arian Paço

Zëvendësrektor

Prof. Asoc. Dorian Çene

Zëvendësrektor



Prof. Arben Llozi

Dekan, FM



Prof. Sadik Spahija

Dekan, FAB



Prof. Miltiadh Kutali

Dekan, FAS



Alma Sinanaj

Administrator

